LIGJ
Nr. 56/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8876, DATË 4.4.2002 "PËR SHËNDETIN RIPRODHUES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 42, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Shkeljet e rregullave të parashikuara në këtë ligj, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) për ushtrim profesioni në fushën e shëndetit riprodhues nga mjekët e këtij specialiteti pa licencë, me gjobë nga 25 000 deri në 100 000 lekë;

b) për funksionimin e institucioneve shëndetësore private pa licencë në fushën e shëndetit riprodhues, me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë.".

Neni 2

Në nenin 42, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

"3. Masa e gjobës është dënim kryesor kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues kur jepet njëkohësisht me masat e parashikuara në pikën 2.

4. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

5. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

6. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.".

Neni 3
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8015, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani